



BISLIMI THOTË SE PA NËNSHKRIM TË MARRËVESHJEVE NUK DO TË NISË ZBATIMI I ASOCIACIONIT



Kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, ka thënë se pa nënshkrim të marrëveshjeve të arritura deri

më tani, nuk mund të ecet përpara drejt zbatimit të tyre, duke përfshirë edhe Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Këtë deklaratë Bislimi e tha një ditë më parë pas takimit që pati në Bruksel me të dërguarin evropian Miroslav Lajçak

AKTUALE



BE-ja PAJTOHET ME ZELENSKYN PËR RREZIKUN NGA NDIKIMI I RUSISË NË BALLKAN F. 2

POLICIA SHTON KONTROLLET PËR VERIFIKIMIN E SHOFERËVE QË NUK I KANË PAJISJET DIMËRORE F. 4

KRASNIQI TAKON NË BRUKSEL ZYRTARËT E ALDE-S, DISKUTOJNË PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË KOSOVË F. 5

EKONOMI



FMN-ja VLERËSON PËRPARIMIN E BQK-së F. 8

BORDI I DREJTORËVE I AKP-SË MIRATOI RAPORTIN TREMUJOR, PRITET T'I DORËZOHET KUVENDIT F. 8

SPORT



SHQIPËRIA E MREKULLUESHME, SIGURON KUALIFIKIMIN NË KAMPIONATIN EVROPIAN F. 10

KUVENDI MIRATON NË PARIM BUXHETIN PËR VITIN 2024

FAQE 3



KOSOVA DHE SIGURIA E BALLKANIT PERËNDIMOR PAS BANJSKËS

Dr. Jasmin MUJANOVIQ

FAQE 6-7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fac: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Stoltenbergu viziton Kosovën dhe rajonin

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, më 20 nëntor do ta vizitojë Kosovën në kuadër të një vizite në disa vende të Ballkanit. Ai pritet të takohet me presidenten e shtetit, Vjosa Osmani, në pasditen e së hënës. Sipas njoftimit të NATO-s, Stoltenbergu do ta nisë vizitën në Ballkan fillimisht në Bosnjë-Hercegovinë gjatë paradites së 20 nëntorit. Të nesërmen do të jetë në Serbi dhe Maqedoni të Veriut. Në këtë të fundit do të qëndrojë edhe më 22 nëntor. Prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, janë pjesë e aleancës. Zyrtarët shtetërorë të Kosovës kanë shprehur disa herë synimin për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Vitin e kaluar kryeministri i

Kosovës e ka përmendur se synon që vendi të anëtarësohet në programin e NATO-s, Partneriteti për Paqe. Shtetet e Bashkuara e kanë mbështetur këtë vendim të Kosovës, ndonëse kanë tërhequr vërejtjen se për një anëtarësim të tillë duhet miratim i të gjitha vendeve të aleancës. Nga 31 vende anëtare të NATO-s, Kosovën si shtet të pavarur e kanë njohur 27 prej tyre, ndërsa katër (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja) ende jo. Partneriteti për Paqe është një program i NATO-s që synon krijimin e besimit midis shteteve anëtare të NATO-s dhe shteteve të tjera në Evropë. Aktualisht NATO-ja është në Kosovë përmes misionit të saj KFOR. Deri në nëntor të vitit 2023 pjesë e këtij misioni kanë qenë 4 687 trupa prej 27 vendeve të botës.



BE-ja nuk do t'i eksportojë mbeturinat në vendet që s'mund t'i përpunojnë ato

BRUKSEL, 17 NËNTOR - Ligjvënësit e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare kanë arritur një marrëveshje për ta rishikuar rregulloren e bllokut për dërgesat e mbeturinave dhe për t'u dhënë fund eksporteve të llojeve të caktuara të tyre në vendet e treta që nuk janë në gjendje t'i përpunojnë siç duhet, tha Parlamenti i BE-së të premten. "Eksportet e disa mbeturinave jo të rrezikshme dhe përzierjet e tyre (...) do të lejohen vetëm në ato vende që nuk janë anëtare të OECD-së që pranojnë dhe përmbushin kriteret për trajtimin e mbetjeve të tilla në një mënyrë të shëndoshë



mjedisore", tha parlamenti. Shtohet se do të merret parasysh edhe pajtueshmëria me të drejtat ndërkombëtare të punëtorëve. Në vitin 2021 Komisioni Evropian propozoi një rinovim të rregullave të BE-së për dërgesat e mbeturinave për ta bërë më të vështirë për shtetet anëtare shkarkimin e tyre në vendet më të varfra. "BE më në fund do ta marrë përgjegjësinë për mbeturinat e saj plastike duke ndaluar eksportin e tyre në vendet joanëtare të OECD-s", tha në një deklaratë ligjvënësi danez Pernille Weiss. Vendet e BE-së duhet ta ndalojnë dërgimin e

mbeturinave plastike në vendet më të varfra jo më larg se dy vjet e gjysmë nga hyrja e legjislacionit në fuqi, tha parlamenti. Gjithashtu, u bë me dije se do të shtrëngohen rregullat për eksportet e mbeturinave plastike në vendet brenda OECD, grupit të vendeve kryesore të pasura në botë. Në vitet e mëparshme rreth gjysma e eksporteve të mbeturinave të BE-së shkuan në vendet joanëtare të OECD-së me rregulla më të dobëta të menaxhimit të tyre sesa në BE, duke transportuar ndotjen e BE-së jashtë vendit.

BE-ja pajtohet me Zelenskyn për rrezikun nga ndikimi i Rusisë në Ballkan

BRUKSEL, 17 NËNTOR - Bashkimi Evropian ndan shqetësimin e presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky, se Rusia mund të tentojë të nxisë konflikte në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Këtë e ka thënë zëdhënësi i BE-së për çështje të politikës së jashtme dhe të sigurisë, Peter Stano, duke iu përgjigjur pyetjes se a e ndan BE-ja shqetësimin e shprehur nga Zelensky se Rusia do të tentojë të provokojë konflikte në rajonin e Ballkanit Perëndimor. "Për një kohë të gjatë ne kemi thënë se Rusia po bën përpjekje për të ushtruar ndikim malinj edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Pra, po, ky është shqetësimi që ne e ndajmë

dhe ky nuk është shqetësim i ri, por shqetësim që ka qenë me ne për një kohë. Ne në këtë pikë pajtohemi me presidentin e Ukrainës dhe e dimë që Rusia po bën gjithçka që mundet që të mbjellë pakënaqësi, jo stabilitet politik, ndikim të huaj, manipulim informatash dhe të tjera", ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. Ai ka shtuar se pikërisht për këtë arsye BE-ja ka shtuar ndihmën për partnerët në vendet e Ballkanit Perëndimor që të përballen me këto kërcënime. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha në komentet për mediet afrikane më 15 nëntor se

Ukraina ka prova të synimeve të Rusisë për të nisur një luftë midis vendeve të Ballkanit. "Kushtojini vëmendje Ballkanit. Më besoni, ne po marrim informacione. Rusia ka një plan të gjatë. (Së pari kemi pasur) Lindjen e Mesme - shpërqendrimi i dytë do të jetë Ballkani", tha Zelensky. Stano nuk ka dashur të flasë për hollësitë e informatave që kanë apo nëse Zelensky ua ka përcjellë informatat e tij, por ka shtuar se "BE-ja është e vetëdijshme se çfarë po tenton të bëjë Rusia në Ballkanin Perëndimor". "Ne nuk i komentojmë informatat të cilat i shkëmbejmë me partnerët. Sidomos jo kur është fjala për diçka specifike si kjo. Por, ne



kemi informata dhe i kemi vëzhguar këto aktivitete të Rusisë për një kohë dhe jemi të vetëdijshëm se çfarë tenton të bëjë Rusia. Prandaj, jemi në kontakt me partnerët edhe në Ballkan për këtë", tha

ai, duke shtuar se për këtë është diskutuar edhe në takimin e fundit të ministrave të Jashtëm të vendeve të Bashkimit Evropian me kolegët e tyre nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Nis puna për hekurudhën Prishtinë - Durrës, kompania austriake fituese e projektit

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Ka nisur puna për realizimin e hekurudhës Durrës - Prishtinë. Tashmë është shpallur kompania fituese e cila do ta realizojë studimin e fizibilitetit për linjën hekurudhore e cila pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në ekonominë e dy vendeve, Kosovë - Shqipëri. "KosovaPress" merr vesh se mes pesë ofertave, fituese është shpallur ajo e bashkimit të dy kompanive, konzorciumi "ILF Consulting Engineers Austria GmbH" - Abkons Sh.PK. që ofruan 168.9 milionë lekë nga

200 milionë lekë (20 milionë euro) që ishte taveni për ta realizuar projektin që do t'i lidhë dy vendet me linjë hekurudhore, Kosovën dhe Shqipërinë.

Drejtuues të Ministrisë së Infrastrukturës në Kosovë nuk kanë qenë të qasshëm për të dhënë hollësi lidhur me këtë projekt.

Konzorciumi do të ketë afat 14 muaj për ta bërë studimin e fizibilitetit dhe për ta ndërtuar projekt-idenë e hekurudhës Durrës-Prishtinë. Ndërsa në vitin 2025 projekti do të jetë gati

për të nisur më pas punën në terren.

Bashkimi i operatorëve që fitoi ishte shkualifikuar herën e parë nga autoriteti kontraktor, por pas ankimit Komisioni i Prokurimeve Publike në prill vendosi rihapjen e garës dhe në fund arritën që të fitonin. Megjithatë, vetëm pas përfundimit të fizibilitetit do të ketë një pasqyrë përfundimtare të kostove financiare. Gjatësia totale e linjës hekurudhore nga stacioni i Mjedës deri në kufirin me Kosovën është rreth 107 kilometra.



Kuvendi miraton në parim buxhetin për vitin 2024

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2024. Për këtë projektligji kanë votuar 62 deputetë.

Në votim nuk morën pjesë deputetët e partive opozitare, përkatësisht të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ata të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Projektligji është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 31 tetor, ndërsa shumica e paraparë buxhetore kap vlerën e mbi 3.3 miliardë eurove, nga 3.2 miliardë sa ishte në këtë vit.

Nga kjo shumë mbi 1 miliard euro parashihet të shkojnë për subvencione dhe transfere, mbi 850 milionë euro për shpenzime kapitale, mbi 800 milionë euro për paga dhe shtesa dhe afër 500 milionë euro për mallra dhe shpenzime.

Pesë institucionet me buxhetin më të madh në vitin 2024 pritet të jenë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me 931.025.963 euro, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me 265.445.995 euro, Ministria e Punëve të Brendshme me 216.523.467 euro, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me 174.387.768 euro dhe Ministria e Mbrojtjes me 153.049.911 euro.

Sipas Qeverisë së Kosovës, buxheti do të rritet në disa sektorë vitin e ardhshëm, përfshirë: sigurinë, shëndetësinë, ekonominë dhe arsimin.



Buxheti i vitit 2024 parasheh edhe rritjen e koeficientit të pagave nga 105 euro - sa është aktualisht - në 110.

Kryeministri Albin Kurti në fjalën e tij para deputetëve ka theksuar se buxheti i vitit 2024 do të jetë prioritet në programin e tyre qeverisës sa iu përket nevojave të qytetarëve për një ekonomi të fortë, me më shumë vende të punës; për shëndetësi gjithëpërfshirëse me shërbime më të mira; arsim të zhvilluar me cilësi më të lartë; e sundim të ligjit

me drejtësi të reformuar.

Buxheti i komunave nga 547 milionë euro sa ishte në vitin 2021, do të rritet në 654 milionë euro në vitin 2024. "Buxheti i komunave në vitin 2021 ishte 547 milionë euro. Sivjet është 654 milionë euro. Në vitin 2024 ai do të jetë gati 200 milionë më shumë sesa në vitin e parë të qeverisjes sonë, ose 742 milionë euro, prej të cilave 635 milionë euro janë grant për komunat nga qeveria, kurse pjesa tjetër janë të hyra vetjake të komunave. Pra ky buxhet i

qeverisë është, po ashtu, edhe buxhet i komunave", është shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se buxheti i vitit të ardhshëm përsëri do të jetë edhe buxhet për shqiptarët e Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Por, deputetët e partive opozitare e kanë kritikuar buxhetin e paraparë për vitin e ardhshëm. Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se ky buxhet ka shpërputhje me zotimet që i ka

qeveria.

Ndërkaq deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka akuzuar qeverinë Kurti për diskriminimin e komunave të cilat nuk qeverisen nga Lëvizja Vetëvendosje.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se me një lexim të kujdesshëm shihet qartë se me këtë dokument qeveria ka goditur shtyllat vitale të ekonomisë, duke theksuar se e ka kthyer buxhetin në skema sociale.

811 raste të thyerje së gurëve në veshkë u realizuan për nëntë muaj në Klinikën e Urologjisë

PRISHTINË, 17 NËNTOR - 811 raste të thyerje së gurëve në veshkë janë realizuar në nëntë muajt e parë të vitit 2023 nga urologët në bashkëpunim me anesteziologët në Klinikën e Urologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. "Në po këtë klinikë janë realizuar

edhe 798 operacione të hapura dhe endoskopike, po ashtu ka pasur 1 474 procedura të njohura si ureterocistoskopi dhe aplikim të stentave ureterale, 134 raste të ekzaminimeve urokinematike, 193 aplikime të nefrostomave, mbi 7 600 vizita emergjente, 5

600 vizita ambulatorë", ka njoftuar QKUK-ja.

Më tej është theksuar se janë bërë edhe 227 biopsi të prostatës.

Po në Klinikën e Urologjisë janë realizuar edhe ekzaminime të tjera urologjike.





Bislimi thotë se pa nënshkrim të marrëveshjeve nuk do të nisë zbatimin e Asociacionit

Kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, ka thënë se pa nënshkrim të marrëveshjeve të arritura deri më tani, nuk mund të ecet përpara drejt zbatimit të tyre, duke përfshirë edhe Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Këtë deklaratë Bislimi e tha një ditë më parë pas takimit që pati në Bruksel me të dërguarin evropian Miroslav Lajçak

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Kosova dhe Serbia diskutuan të enjten në Bruksel në nivel kryenegociatorësh zbatimin e marrëveshjes së arritur më herët gjatë këtij viti për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. I dërguari evropian Miroslav Lajçak zhvilloi takime të ndara me delegacionin serb të drejtuar

nga kryenegociatori Petar Petkoviç, për të vazhduar më pas me atë të Kosovës, të drejtuar nga zëvendëskryeministri Besnik Bislimi.

Lajçaku shkroi në rrjetet sociale se "diskutimet ishin të dobishme për të bërë përparim në një sërë çështjesh në agjendën tonë". Kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë pas takimit se me Lajçakun, nuk është diskutuar për

Asociacionin e Komunave Serbe pasi, sipas tij, Kosova ka qëndrim të qartë për këtë çështje. "Në agjendë ka qenë si pikë, mirëpo ne vetëm i kemi treguar Lajçakut që ne kemi një pozicion të qartë të artikuluar më 26 tetor në takimin që Kurti kishte me udhëheqësit evropianë, që ne jemi të gatshëm ta pranojmë dokumentin në plotëni, të nënshkruar së bashku me dy dokumentet e tjera të rëndësishme, marrëveshjen bazike dhe aneksin implementues. Nuk kemi pasur nevojë për sqarime shtesë nga Bashkimi Evropian, prandaj edhe nuk kemi diskutuar", ka theksuar zëvendëskryeministri Bislimi.

Bislimi ka theksuar se projektstatut i propozuar nga vendet perëndimore ka pasur një

kujdes të shtuar lidhur me kushtetutshmërinë e vendit. Ai tha se Asociacioni nuk mund të nisë të zbatohet pa nënshkrim të marrëveshjeve. "Jo, nuk mund të nisë, për arsye se duhet garanci që kemi një marrëveshje valide e cila pastaj krijon obligime edhe për palën tjetër", ka deklaruar ai. I pyetur nëse qëndron deklarimi i zyrtarëve evropianë se draftstatuti i paraqitur është versioni më i mirë që ka pranuar Kosova, Bislimi ka thënë se një qëndrim i tillë është subjektiv, sepse "Kosova nuk ka pasur deri më tani oferta". "Kemi pasur draftte që kanë qarkulluar, por mund të themi që drafti që i është dorëzuar Kosovës nga miqtë tanë të Bashkimit Evropian dhe të ShBA-së, gjatë përgatitjes së neneve, ka pasur një kujdes të shtuar për provizionet kushtetuese të Kushtetutës së

Kosovës", duke shtuar se çështja nëse është ai dokument plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës vendos Gjkata Kushtetuese.

I pyetur nëse do të ketë një takim të radhës në kuadër të dialogut në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, deri në fund të vitit, Bislimi ka thënë se Lajçaku nuk ka përmendur datë konkrete. "Është fakt që zgjedhjet në Serbi e kanë dëmtuar shumë procesin, për arsye se janë caktuar si obstrukcion për ecurinë e procesit të dialogut. Kjo sjell paqartësi se si mund të ecim tutje. Sot gjatë takimit nuk është diskutuar asesi asnjë moment opsioni për takime të radhës", ka pohuar Bislimi. Propozimi për projektstatutin e Asociacionit u është dorëzuar

Haradinaj: Asociacioni do të jetë 'bombë e kurdisur' brenda Kosovës, Kurtit i ka humbur rruga në oborr

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Ish-deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti. Ai ka thënë se shefi i ekzekutivit nga tri herë në ditë i ndryshon qëndrimet. Në një intervistë për gazetën "Nacionale", Haradinaj ka thënë se kryeministrin Kurti i ka humbur rruga në oborr. Sipas tij, Kurti është duke i sjell dëme historike Kosovës me pranimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Është jashtë, i ka humbur rruga në oborr, nuk ke di as ku



është. Me çuditin deputetët e pozitës që heshtin. E shohin që një dëm historik është duke i ardhur Kosovës dhe i mbyllin sytë para kësaj situatë. Kjo pak është e çuditshme. Këtu nuk bëhet llaflaf për një kryeministër ose një asociacion të një kryeministri, po bëhet llaflaf për Kosovën. Ky Asociacion mendoj se do të jetë një bombë e kurdisur brenda Republikës së Kosovës. Ne po i japim fuqi ekzekutive. Njëfarë mini Republika Serpska është duke ndodhur në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Policia shton kontrollet për verifikimin e shoferëve që nuk i kanë pajisjet dimërore

MITROVICË, 17 NËNTOR - Policia në Mitrovicën e Jugut ka shtuar aktivitetet për vetëdijesimin e shoferëve që të mos drejtojnë automjetin pa pajisje dimërore. "Me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit /sensibilizimit të shoferëve që mos të dalin në trafik pa i pajisur veturat me pajisje dimërore, policia në rajonin e Mitrovicës së Jugut, nga data 15 nëntor po shpërndan fletëpalosje për shoferë me këshilla kryesore për përgatitjen dhe ngasjen e automjeteve gjatë sezonit dimëror. Me fillimin e sezonit dimëror njësitet policore do ta rritin kontrollin nëpër akset rrugore ku në fokus do të jenë pajisjet dimërore për automjete", ka njoftuar Policia e Kosovës. Për drejtuesit e automjeteve që nuk respektojnë rregullat e



parapara sipas ligjit të komunikacionit rrugor do të shqiptohen gjoba. Për persona fizikë gjoba është 40 euro, ndërsa për persona juridikë gjoba është 100 deri në 300 euro.

Policia e Kosovës u ka bërë thirrje të gjithë shoferëve për kujdes të shtuar që t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e trafikut rrugor si dhe t'u përshtaten kushteve të rrugës.

palëve më 21 tetor nga të dërguarit amerikanë dhe evropianë. Më 26 tetor udhëheqësit e Gjermanisë, të Francës, të Italisë dhe të institucioneve të Bashkimit Evropian takuan ndarazi në Bruksel kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për të diskutuar rrugën përpara drejt normalizimit. Udhëheqësit e vendeve kryesore të Bashkimit Evropian kërkuan nga Kosova themelimin e Asociacionit, ndërsa nga Serbia njohjen de fakto të Kosovës. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se ishte i gatshëm ta nënshkruante propozimin për statutin, por akuzoi presidentin serb Aleksandër Vuçiq se refuzoi të nënshkruante. Presidenti serb tha se propozimi paraqet bazë të mirë për bisedime të mëtejme, por hodhi poshtë çdo mundësi të njohjes së pavarësisë së

Kosovës. Propozimi për themelimin e Asociacionit, i cili ende nuk është bërë publik, ka nxitur debate të shumta në Kosovë, ku janë shfaqur disa propozime, vërtetësia e të cilëve nuk është pohuar nga diplomatët perëndimorë që kanë kërkuar trajtimin e çështjes në mirëbesim. Javën e kaluar ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, i vlerësoi të paarsyeshme debatet rreth kushtetutshmërisë së statutit duke nënvizuar se propozimi është hartuar me shumë kujdes dhe duke respektuar në tërësi Kushtetutën e Kosovës. Themelimi i Asociacionit është detyrim i përfshirë në marrëveshjen e Brukselit dhe të Ohrit e cila synonte t'i ulte tensionet ndërmjet palëve, të cilat që atëherë u përkeqësuan duke arritur një pikë të lartë në

fund të muajit shtator pas një sulmi mbi policinë e Kosovës nga një grup serbësh të armatosur, ku mbeti i vrarë një oficer policie. Ndonëse e vlerësojnë pozitive deklaratën e udhëheqësve evropianë për pritshmëritë e tyre nga palët, ata pohojnë se gjasat janë të vogla që ajo do të ndikojë në pozicionet e palëve. Komisioni Evropian e ka kritikuar Kosovën dhe Serbinë për mungesë gatishmërie për t'i zbatuar obligimet që dalin prej marrëveshjeve paraprake. Në Raportin e Progresit të këtij Komisioni është konstatuar se palët nuk kanë nisur fare ta zbatojnë Marrëveshjen drejt normalizimit. Në këtë raport Komisioni Evropian ka bërë ftesë për Kosovën dhe Serbinë që t'u qasen më me përgjegjësi obligimeve nga dialogu, duke rikujtuar se diçka e tillë është kyçe për përparimin e tyre në procesin e

Krasniqi takon në Bruksel zyrtarët e ALDE-s, diskutojnë për zhvillimet e fundit në Kosovë

BRUKSEL, 17 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka takuar në Bruksel presidentin e ALDE-s, Ilhan Kyuchyuk dhe Sekretarin e Përgjithshëm, Didrik De Schaetzen. Krasniqi në "Facebook" ka njoftuar se me dy zyrtarët e ALDE-s kanë diskutuar për zhvillimet e fundit në Kosovë. "Që nga 3 dhjetori i vitit të kaluar, kur PDK u bë anëtare me të drejta të plota në Partinë Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve të Evropës (ALDE) - bashkëpunimi

i ndërsjellë ka qenë në nivel të shkëlqyeshëm. Në Bruksel, presidentin Ilhan Kyuchyuk dhe Sekretarin e Përgjithshëm Didrik De Schaetzen, i falënderova për mbështetjen e vazhdueshme ndaj PDK-së. Bashkë me dy miqtë e mi diskutuam edhe për zhvillimet e fundit politike në Kosovë, rajon dhe Evropë, e veçanërisht për përgatitjet e partive anëtare të ALDE-s për zgjedhjet e ardhshme për Parlamentin Evropian, në pranverën e vitit 2024", ka njoftuar Krasniqi.



integritimeve evropiane. Analisti Petrit Zogaj ka vlerësuar se kryeministri Albin Kurti është në kërkim të projekteve të ish-kryeministrin Hashim Thaçi në procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se kryeministri Kurti është në kërkim të Asociacionit që dikur Hashim Thaçi e ka pranuar në parim. Në këtë kontekst, Zogaj ka thënë se një gjë e tillë është e

paarritshme. "Kryeministri Kurti është në kërkim të Asociacionit që Thaçi e kishte pranuar në parim. Por, siç duket, kjo jo me që s'është e mundur, por Kurti tashmë edhe sikur ta kërkonte zbatimin e idesë së shkëmbimit të territoreve, prapë ide e Thaçit, nuk do të jetë në gjendje ta bëjë. E gjithë kjo falë gjenialitetit të tij të negociimit", ka shkruar Zogaj në "Facebook".

Kosova dhe siguria e Ballkanit Perëndimor pas Banjskës



Dr. Jasmin MUJANOVIQ

-Rekomandime politike nga Instituti për Studime të Luftës Hibride Octopus

Hyrje

Sulmi paraushtarak nationalist serb në Banjskë, në veri të Kosovës, i cili rezultoi me vrasjen e një oficeri të Policisë së Kosovës dhe plagosjen e dy të tjerëve, përfaqëson shembullin më të rëndë të dhunës në vend që nga fundi i luftës së vitit 1999 dhe ndërhyrjes së NATO-s.

Në Banjskë ne shohim prova demonstruese se Beogradi ka një vullnet të ripërtërirë për ta përdorur dhunën për t'i formësuar kushtet politike në shtetet fqinje. Përfshirja e drejtpërdrejtë e shërbimeve të sigurimit shtetëror serb në sulm - përmes sigurimit të armëve dhe municioneve, përdorimit të

objekteve të tyre ushtarake për përgatitjen e sulmit dhe lidhjeve të njohura të sulmuesve me nivelet e larta të udhëheqjes serbe - kërkon një reagim përbajtësor nga kryeqytetet e Quintit dhe vetë Qeveria e Kosovës.

Raporti i mëposhtëm paraqet pesë rekomandime politike për t'iu përgjigjur në mënyrë të duhur ngjarjeve në Banjskë, duke siguruar, mbi të gjitha, se Beogradi nuk do të rrezikojë ndonjë përshkallëzim të mëtejshëm të dhunës. Pasoja kredibile dhe ngritja e kapaciteteve bindëse parandaluese në Prishtinë janë kyçe për ta garantuar stabilitetin e Kosovës dhe të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Nëse elementët nationalistë serbë tolerohen të besojnë se dhuna është edhe një herë një mjet i lejuar i ndikimit politik, ata

nuk do të rrezikojnë thjesht sigurinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës. Me kalimin e kohës, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi gjithashtu ka të ngjarë të jenë në shënjestër. E njëjta gjë do të rezultonte gjithashtu në një regres të mëtejshëm demokratik në Serbi, gjë që do t'i rriste gjithashtu gjasat për konflikt ndërshtetëror në rajon. As NATO-ja dhe as BE-ja nuk mund të përballojnë një tjetër krizë me disa fronte në rajon, veçanërisht duke pasur parasysh ndryshimin e theksuar të kushteve gjeopolitike globale që nga shkurti i vitit 2022. Prandaj, nëse zbatohen rekomandimet në këtë raport, jo vetëm që do ta përmirësonin ndjeshëm stabilitetin dhe sigurinë e Kosovës por, gjithashtu, do t'i siguronin interesat e Perëndimit për

ruajtjen e një mjedisi paqësor në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Kjo, në fund të fundit, është edhe shtytja kryesore analitike e këtij teksti: duke theksuar se është në interes të komunitetit euroatlantik, para së gjithash, të ketë një Kosovë sovranë, demokratike, siguria e së cilës ruhet në mënyrë të besueshme nga shërbimet e saj të zbatimit të ligjit dhe të sigurisë. Në këtë aspekt, Serbia, në kursin e saj aktual, është një kundërshtar, jo partner. Por, duke çimentuar mbështetjen dhe angazhimet perëndimore për Kosovën, ne mund të sigurojmë, me kalimin e kohës, se klasa politike e Serbisë do të pranojë se trajektorja e saj aktuale maksimaliste është një propozim humbës: ndërkombëtarisht, por edhe brenda vendit. Një shtet i fortë, sovran i Kosovës - së bashku me

Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Malin e Zi - janë pakrahasimisht mjetet më të mëdha në dispozicion të komunitetit euroatlantik për ta lehtësuar përfundimisht pranimin e vërtetë në shoqërinë serbe se luftërat jugosllave kanë mbaruar dhe se projekti nationalist dhe ekspansionist serb - qoftë i quajtur si "Serbia e Madhe" apo "Bota Serbe" - janë mposhtur.

Rekomandimi 1: Ngrirja e dialogut Prishtinë - Beograd në pritje të një raporti të plotë dhe të paanshëm për ngjarjet në Banjskë nga një Task Force e NATO-s

Përpjekja për të rifilluar dialogun Prishtinë-Beograd aktualisht është e pamatur dhe

e paarsyeshme. Së pari, duke marrë parasysh mungesën e sanksioneve formale kundër Serbisë si nga SHBA ashtu edhe nga BE pas ngjarjeve në Banjskë, një përpjekje e tillë dërgon në mënyrë implicite sinjalin se Perëndimi zyrtar është i gatshëm të tolerojë përdorimin e forcës për të formuar dhe drejtuar negociatat politike midis dy palëve. Si një sinjal edhe për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, kjo është thellësisht shkatërruese për interesin e vetë Perëndimit për të promovuar normat ndërkombëtare dhe sundimin e ligjit. As Kosova, si shtet sovran, nuk mund të lejohet që të detyrohet në negociatat politike apo diplomatike me një qeveri që nxit dhunën në territorin e saj; është një propozim politikisht vetëvrasës për çdo qeveri demokratike.

Së dyti, këmbëngulja për rifillimin e dialogut bie ndesh me parimet e politikës perëndimore të shprehura qartë në pika të tjera krizash gjeopolitike të vazhdueshme, mbi të gjitha në Ukrainë dhe Izrael. Si në rastin e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, ashtu edhe në sulmet terroristë të Hamasit kundër Izraelit, SHBA-të dhe kryeqytetet e tjera të Quintit kanë hedhur poshtë negociatat si një alternativë e besueshme ndaj interesave të sigurisë bazë të shteteve ukrainase dhe izraelite. Edhe pse Kosova nuk është në gjendje lufte aktive, Serbia ka nisur qartë një fushatë hibride kundër vendit dhe qytetarëve të saj, dhe si e tillë Kosova duhet të insistojë në të njëjtat parime themelore të sigurisë si Ukraina dhe Izraeli. Domethënë, ajo duhet të sigurojë kontroll të plotë juridiko-politik mbi çdo pjesë të territorit të saj përpara se të mund të shqyrtojë në mënyrë të besueshme ndonjë reformë administrative-kushtetuese alternative të shtetit.

Dështimi për ta bërë këtë vetëm do të lehtësojë shfaqjen e një regjimi politik paralel dhe kundërshtar në territorin e Kosovës, edhe nëse i njëjti do të inkorporohet nominalisht në rendin kushtetues të vendit. Mjafton të shikohet entiteti Republika Srpska në BeH dhe autoritetet e saj secesioniste, për të pranuar se dialogu dhe transferimi pa një aparat funksional, racional të sigurisë dhe juridik, që vepron lirshëm në të gjithë territorin e shtetit, do të prodhojë vetëm më shumë kaos. Si i tillë, rivendosja e mundësisë për rifillimin e dialogut kërkon një llogaritje të plotë të ngjarjeve në Banjskë nga një entitet i paanshëm, i palës së tretë si KFOR-i ose një shërbim inteligjent që ka lidhje me aleancën e atlantiko-veriore. Pasi faktet e sulmit të jenë vërtetuar plotësisht dhe autorët të jenë sanksionuar siç duhet (në kuptimin politik dhe penal-juridik), dialogu mund të

rifillojë me synimin drejt krijimit të një kornize të barabartë, por edhe funksionale për qeverisjen e ardhshme të Kosovës.

Rekomandimi 2: Rritje e asistencës së sigurisë për Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës

Siç u përmend më lart, Kosova duhet të njihet si palë sovraane në kontekstin e mosmarrëveshjes me Serbinë, pavarësisht nga pozicioni/pozitat e Beogradit dhe pesë vendeve mosnjohëse të BE-së. Prandaj, Kosova duhet t'i gëzojë të drejtat për të gjitha dispozitat e njëjta të shtetësisë si çdo aktor tjetër sovran, aspekti më themelor i të cilit është monopoli i sigurisë mbi të gjithë territorin e shtetit. Prandaj, Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme, por edhe të shtuar për të qenë në gjendje të projektojnë forcën dhe të ruajnë rendin dhe ligjin në të gjitha pjesët e Kosovës, duke përfshirë edhe veriun. Gjatë sulmit në Banjskë, Policia e Kosovës u tregua si një forcë efikase dhe profesionale, e aftë për të neutralizuar me aftësi një sulm paraushtarak shumë të sofistikuar, të mbështetur nga shteti. Por Serbia pa dyshim vazhdon të gëzojë një avantazh të rëndësishëm ushtarak kundër Kosovës. Prandaj, është me rëndësi të madhe që NATO të ndihmojë agjencitë e zbatimit të ligjit dhe të sigurisë të Kosovës në (ri)krijimin e një kapaciteti të besueshëm parandalues, me synimin drejt vendosjes së një ekuilibri më të gjerë rajonal të fuqisë kundër Beogradit.

Autoritetet e Kosovës duhet t'i komunikojnë Quintit dhe NATO-s se çfarë resurse të sakta kërkojnë, por është e qartë se kjo listë do të përfshijë domosdoshmërisht automjete të blinduara të lëvizshmërisë së lartë për policinë e Kosovës, sisteme kundër mjeteve të blinduara dhe sisteme anti-artileri për FSK-në, si dhe Helikopterë për shërbimet e emergjencës së vendit (shih dorëzimin e vitit 2022 të helikopterëve amerikanë Huey II në Forcat e Armatosura të Bosnje-Hercegovinës).

Rekomandimi 3: Anulimi i masave të ShBA-së dhe BE-së kundër Kosovës

Në ndërkohë, është e domosdoshme që masat e SHBA-së dhe BE-së kundër Kosovës, të vendosura në fillim të këtij viti pas trazirave nacionaliste serbe në Zveçan, e cila rezultoi në lëndime të më shumë se dy duzinave me ushtarë të KFOR-it, të anulohen. Këto kuazi-

sanksione pa dyshim e trimëruan më tej Vuçiqin dhe elementët ekstremistë serbë të lidhur përpara sulmit në Banjskë dhe rritën asimetrinë ekzistuese në qëndrimin e komunitetit ndërkombëtar ndaj të dy palëve.

Zyrtarët perëndimorë mund të vazhdojnë të jenë të zemëruar nga kundërshtimi i qeverisë Kurti ndaj implantimit të njëanshëm të Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, domethënë transferimit të mëtejshëm të autoriteteve të qeverisjes lokale në një pjesë të vogël të komunave me shumicë serbe në veri, pa ndonjë lëvizje politike nga Beogradi. Por qeveria Kurti ka ofruar lëshime të arsyeshme drejt realizimit të së njëjtës, dhe shqetësimet e saj për armatosjen e elementeve kriminale dhe ekstremiste brenda veriut nga ana e Serbisë janë dëshmuar, fatkeqësisht, të matura dhe të sakta. Sidomos në lidhje me krahasimin e shpeshtë të Kryeministrit të modaliteteve ekzistuese të "Asociacionit të Komunave Serbe" të mbështetura nga SHBA dhe BE me modelin e dështuar të Republikës Srpska nga Bosnja dhe Hercegovina. Bisedat ndërmjet Prishtinës dhe Quintit në lidhje me skemat alternative qeverisëse për veriun e Kosovës mund dhe duhet të vazhdojnë; jo më pak sepse Prishtina duket se është e vetmja palë në dialog e gatshme për të diskutuar dhe debatuar këto çështje. Por bisedime të tilla mund të jenë vërtet të frytshme vetëm nëse SHBA-ja dhe BE-ja korrigjojnë gabimin e masave të tyre të mëparshme kundër Kosovës. Për Prishtinën, sigurimi i këtij ndryshimi të politikës është një çështje themelore e llogaridhënies demokratike ndaj qytetarëve të saj, të cilët kanë treguar qartë se nuk do të tolerojnë qeveritë që bëjnë kompromis me sigurinë bazë të vendit dhe interesat politike. Mjerisht, duke pasur parasysh mungesën e proceseve të mirëfillta demokratike në Serbi, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për regjimin në Beograd.

Rekomandimi 4: Pranimi i menjëhershëm i Kosovës në Partneritetin për Paqe të NATO-s

Lëvizje të vogla por jashtëzakonisht të rëndësishme duhet të ndërmerren gjithashtu për të përmirësuar pozitën e Kosovës brenda komunitetit ndërkombëtar. Ndoshta, më me ndikim prej tyre - i cili gjithashtu do të përmirësonte pozicionin dhe kapacitetet e sigurisë së vendit - do të ishte pranimi i Prishtinës në programin e Partneritetit për Paqe (PfP) të NATO-s. Ky është një vendim që NATO mund ta japë pa pëlqimin apo inputin e Serbisë, Rusisë apo Kinës. Barriera më e

rëndësishme është mosnjohja e sovranitetit të Kosovës nga katër shtete anëtare të NATO-s. Megjithatë, pa dyshim, Aleanca ka kapacitetin për të siguruar pranimin e Kosovës në programin e PfP-së edhe nëse jo-njohësit mbajnë zyrtarisht qëndrimet e tyre ekzistuese; ata thjesht nuk do të duhej të kundërshtonin hyrjen e Kosovës në program. Kjo do të thotë, ata nuk duhet të mbështesin aspiratat e PfP-së të Kosovës, ata duhet vetëm të abstenojnë.

Ky do të ishte një kompromis i arsyeshëm pasi do t'u lejonte katër jo-njohëse të ruanin gjerësisht qëndrimet e tyre aktuale diplomatike, duke përmirësuar njëkohësisht pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe aftësinë e NATO-s për të modernizuar dhe zhvilluar aftësitë mbrojtëse të Prishtinës. Kjo do t'i dërgonte gjithashtu një sinjal të nevojshëm Beogradit se aktivitetet e tij destruktive nuk do të tolerohen pafundësisht nga komuniteti Atlantik. Së fundi, do të ishte gjithashtu një paralajmërim i qartë ndaj Rusisë dhe Kinës, të cilët kanë ardhur gjithnjë e më shumë në mendimin se janë ata - jo NATO që përcaktojnë kushtet e angazhimit në Ballkanin Perëndimor.

Rekomandimi 5: Rritja e presionit diplomatik mbi pesë vendet jonjohëse të BE-së për t'i zhblokuar perspektivat e Kosovës në BE dhe NATO

Siç vërehet në këtë tekst, asimetria aktuale në statuset ndërkombëtare të Serbisë dhe Kosovës, përkatësisht, vetëm sa e ka përkeqësuar pazgjidshmërinë e dukshme të mosmarrëveshjes. Në mënyrë të veçantë, ajo ka forcur artificialisht qëndrimin pengues të Serbisë, edhe pse SHBA-ja dhe BE-ja kanë shpenzuar kapital të jashtëzakonshëm diplomatik dhe politik për t'i çuar të dy palët drejt normalizimit. Megjithatë, nuk është Serbia në vetvete ajo që ka lejuar që kjo asimetri të vazhdojë; janë qëndrimet kokëfortë të pesë mosnjohëse të BE-së që kanë lejuar që ky problem të metastazohet në një pikë të dobët gjeopolitike të madhe për të gjithë komunitetin euroatlantik. Kryeqytetet e Quintit duhet të ushtrojnë presion shumë më të madh diplomatik mbi homologët e tyre në këtë grup për t'i shtyrë ata, individualisht dhe kolektivisht, drejt njohjes së plotë të sovranitetit të Kosovës. Duhet shpjeguar, në terma të qartë, se kjo nuk është më një çështje e prioriteteve thjesht të brendshme; është çështje e besueshmërisë dhe integritetit të të gjithë projektit euroatlantik, në Ballkanin

Perëndimor dhe më gjerë. Aktualisht, për shembull, si shefi i politikës së jashtme të BE-së, ashtu edhe i dërguari i BE-së për dialogun Prishtinë-Beograd vijjnë nga shtetet që nuk e njohin Kosovën. Kjo është absurde dhe natyrisht minon besueshmërinë e BE-së si një ndërmjetës i ndershëm në këtë mosmarrëveshje. Një zhvendosje në qëndrim në vetëm një nga pesë kryeqytetet jo-njohëse (ndër të cilët Athina konsiderohet gjerësisht si më e mundshme për të lëvizur) do të ndryshonte ndjeshëm peizazhin strategjik të marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe përfundimisht do ta bënte një zgjidhje përfundimtare shumë më të mundshme. Kjo do të minonte ndjeshëm kredibilitetin e establishmentit nacionalist të vijës së ashpër në Beograd dhe do të dërgonte një sinjal të qartë për të gjithë klasën politike serbe se komuniteti euroatlantik do të ecë përpara me integrimin e Kosovës në rendin demokratik - pavarësisht nga protestat e Beogradit apo ato të partnerë të tij në Moskë dhe Pekin.

Konkluzione

Këto rekomandime, edhe nëse zbatohen, nuk do të jepnin menjëherë një zgjidhje të përhershme për mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi, kryesisht për shkak se thelbi i problemit mbetet, siç ka qenë në pjesën më të madhe të tre dekadave të fundit, në konsensusin politik nacionalist intransigent në Beograd. Por këto rekomandime ofrojnë një rrugë drejt zvogëlimit të varësisë sonë kolektive nga vullneti i mirë (inekzistent) i regjimit të Vuçiqit. Në vend të kësaj, kjo thekson masat vepruese që mund të ndërmerren sot nga komuniteti euro-atlantik, kryesisht pa shqetësim apo ndërveprim me Beogradin ose partnerët e tij në Kremlin apo Pekin.

Ky tekst e bën të qartë se e ardhmja e sigurisë dhe sovranitetit të Kosovës nuk kërkon pëlqimin e kundërshtarëve gjeopolitikë të Perëndimit, të mëdhenj dhe të vegjël. Komuniteti Euro-Atlantik mund të bëjë hapa masivë drejt futjes së kësaj politike të re demokratike në gjirin e saj thjesht me vullnetin e tij, dhe në një kohë kur Perëndimi ka shumë nevojë për fitore strategjike dhe simbolike. Realizimi me sukses i këtij programi do të jepte edhe dividendë për sigurinë dhe stabilitetin e shteteve fqinje, mbi të gjitha Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi, dhe në këtë mënyrë do të përmirësonte sigurinë kolektive të të gjithë rajonit.

Mbetet për t'u parë nëse vendimmarrësit evropianë dhe amerikanë kanë vullnetin politik për të ecur drejt një Ballkani Perëndimor më të qëndrueshëm dhe më të sigurt.

Bordi i Drejtorëve i AKP-së miratoi raportin tremujor, pritet t'i dorëzohet Kuvendit

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e jashtëzakonshme, me ç'rast ka diskutuar për një numër çështjesh të parapara me agjendë dhe ka marrë disa vendime në lidhje administrimin, privatizimin dhe likuidimin e ndërmarreve shoqërore. Gjatë kësaj mbledhjeje Bordi i Drejtorëve shqyrtoi dhe miratoi raportin tremujor të AKP-së që do t'i dorëzohet Komisionit funksional të Kuvendit të Kosovës.

Më pas, Bordi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për aprovimin e qiradhënies direkte për hapësirën në pronësi të N.Sh "Jedinstvo" në Zonën Industriale në Fushë-Kosovë, të cilën kërkesë e miratoi. "Bordi shqyrtoi 15 raporte të prezantuara nga Divizioni për Shitje Direkte për po aq raste (prona), nga të cilat 5 raporte fillestare u aprovuan për inicim të procedurës për shitje me negociim direkt që do t'i nënshtrohen procedurave të tjera të parapara me legjislacion për tu finalizuar

shitja sipas raportit përfundimtar, i cili më pas do t'i paraqitet Bordit për aprovim. Ndërsa 10 raporte për po aq kërkesa të palëve u refuzuan, pasi që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara për shitje me negociim. Bordi diskutoi edhe për çështje të tjera në kuadër të veprimeve që po ndërmerren në AKP për të përmirësuar proceset që kanë të bëjnë me administrimin dhe menaxhimin sa më të mirë të pasurisë shoqërore", është bërë me dije në njoftimin e AKP-së.



Takimet e Bankës Qendrore Evropiane, guvernatori Ismaili paraqet planet e BQK-së për zhvillim dhe modernizim të sistemit të pagesave

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Një delegacion i lartë i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), i kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili, po merr pjesë në takime të nivelit të lartë në Bankën Qendrore Evropiane (BQE) me guvernatorët dhe zëvendësguvernatorët e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor lidhur me integrimin në sistemin evropian të bankave qendrore, përkatësisht në skemën e pagesave SEPA dhe sistemin e pagesave të shpejta TIPS. Punimet i hapi anëtari i Bordit Ekzekutiv i BQE-së, Piero Cipollone, i cili ka zëvendësuar Fabio Panettan që rishtas është emëruar guvernator i Bankës së Italisë. Nga Cipollone u dhanë mesazhet kryesore mbështetëse për këtë nismë.

Në kuadër të katër sesioneve, në të cilat paraqiten bankat qendrore nga shtetet e rajonit, edhe Banka Qendrore e Kosovës përmes guvernatorit Ismaili ka paraqitur punën aktuale dhe planet e BQK-së për zhvillim dhe modernizim të sistemit të pagesave, me qëllim të ndërlidhjes me sistemet rajonale dhe me Bashkimin Evropian. Në margjinat të këtyre takimeve nga ekspertët e Bankës Qendrore Evropiane, Bankës së Italisë,



Bankës së Francës dhe Bankës Qendrore të Gjermanisë u trajtuan tema mbi infrastrukturën e tregut financiar, zhvillimet dhe risitë për instrumentet e pagesave, teknologjitë e reja, valutat digjitale të bankave qendrore dhe euron digjitale. BQE-ja në kuadër të mbështetjes së projektit të BE-së për Modernizimin e Sistemeve të Pagesave të vendeve të Ballkanit

Perëndimor dhe objektivave të G20-s po mbështetet me nisma konkrete siç është ajo e ndërlidhjes së sistemeve të pagesave dhe përfshirjes së rajonit tonë në sistemet e Bashkimit Evropian. Në këtë kuptim, Republika e Kosovës është pjesë e kësaj agjende, ku BQK-ja ka përfshirë në kuadër të Planit Strategjik si një objektivë mundësimin e pagesave të shpejta 24/7, me qëllimin

përfundimtar pjesëmarrjen në sistemin e pagesave TIPS. Avancimi i sistemit kombëtar përmes mundësimin të pagesave "instant" (24/7), si dhe ndërlidhja me sistemin TIPS është objektiv i BQK-së, i cili kur të arrihet do të ketë ndikim të madh në ekonominë e vendit tonë, rajonit, diasporës, si dhe qarkullimin e pagesave për shkëmbimet tregtare me BE-në, si partneri më i madh tregtar i

Republikës së Kosovës. Paraprakisht takim mikpritës për guvernatorin e BQK-së ishte rezervuar nga zëvendës-presidenti i BQE-së, Luis de Guindos, i cili e falënderoi atë për bashkëpunimin e deritanishëm dhe mbështetjen e plotë të BQE-së në këtë projekt shumë të rëndësishëm si në aspektin vendor, po ashtu edhe në procesin integruar.

FMN-ja vlerëson përparimin e BQK-së

PRISHTINË, 17 NËNTOR - "Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka një momentum të ri në zbatim të reformave dhe po punon për forcimin e strukturave qeverisëse të saj. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) po punon për forcimin e strukturave të saj qeverisëse, me mbështetjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)", kështu thuhet në rishikimin më të ri të Bordit Ekzekutiv të FMN-së mbi

Marrëveshjen Stand-By dhe Programit për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri për Republikën e Kosovës. Sipas FMN-së, emërimi i guvernatorit të ri ka sjellë një momentum të ri për zbatimin e reformave në BQK. "Emërimi i guvernatorit të ri të Bankës Qendrore të Kosovës në muajin gusht ka sjellë një momentum të ri për zbatimin e reformave", thuhet në njoftimin e FMN-së. Po ashtu, FMN-ja në këtë

rishikim tregon se në fillim të vitit 2024 ligji i ri për sektorin bankar pritet të dërgohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe BQK-ja është nënshkruese dhe pjesë e programit të fundit "Resilience and Sustainability Facility (RSF)", ku janë përcaktuar disa veprime konkrete dhe të cilat janë duke u zbatuar sipas afateve, siç konstaton edhe komunikata e FMN-së.



Kronika nga vendi më i dhunshëm i Evropës




Sheshi Mendès-France, në Nante. Një e diel si shumë të tjera. Disa djem presin tramvajin në ndalesën përballë tre blloqeve të mëdha të apartamenteve që po rinovohen. Supermarketi i hapur, jeta në lagje ecën si gjithmonë. Përfshirë edhe tregtarët e drogës. Indiferentë edhe ndaj patrullave të policisë që shkojnë e vijnë, qoftë edhe për të treguar se shteti është aty. Ata shpërndajnë dhe të gjithë e dinë që janë gjithmonë aty, rrëzë atyre pallateve, pikërisht në vendin ku një mbrëmje më parë – atë të 7 tetorit – u vra me të shtëna kallashnikovi një 19-vjeçar. Një vrasje e shpejtë: një djalë me skuter qëllon dhe ikën. Viktima është një algjerian pa leje qëndrimi. Ndoshta një larje hesapësh. Atentati i tridhjetë e gjashtë që nga fillimi i vitit në Nantes. Pothuajse një në çdo javë. Përveç Nantes: Nimes, Toulon, periferitë e Parisit dhe Lionit, ka shumë qytete ku hapet zjarr. Në Marsejë ka pasur raportime për të paktën 42 vdekje që nga fillimi i vitit në përleshjet e luftës midis bandave të trafikut të drogës, në lagjet e njohura të periferive veriore. Tre ishin “viktima kolaterale”.

Vdekje aksidentale. Dhe ka lëndime të panumërta. Vrasja e fundit, e dyfishtë, daton disa javë më parë. Por tani ka të shtëna edhe në qendër të qytetit, si më 6 tetor: një njëzet vjeçar u plagos me armë zjarri mes turistëve në zonën e Porto Vecchios. “I njohur për policinë për krime të llojeve të ndryshme”, thuhet në deklaratën e përmbledhur të policisë. Franca ka qenë vendi më i dhunshëm në Evropë për disa vite dhe statistikat po përqësohen. Ka patur terrorizëm, ndikojnë në të dhëna edhe demonstratat e organizuara nga jelekverdhet, e deri te revolta e fundit e periferive. Por nuk është vetëm kaq. Pikërisht në Marsejë, tre vjet më parë, një gjashtëmbëdhjetë vjeçar vendosi të bënte diçka kundër dhunës. Është Amine Kessaci, studenti 19-vjeçar i drejtësisë dhe me shoqatën që themeloi, Ndërgjegjja, flet njëkohësisht për suksesin dhe humbjen: pesë mijë anëtarë në Francë, dhjetëra mijëra njerëz të ndihmuar, përfshirë viktimat e dhunës apo familjet e tyre, por edhe mes atyre që kanë nevojë për ndihmë administrative, apo për të gjetur dialog me institucionet. Ai jeton ende në lagjen Frais Vallon,

ku ka lindur dhe është rritur: “Zonat në veri të Marsejës janë shumë të njohura dhe fatkeqësisht ka shumë varfëri, por përtej kësaj njerëzit flasin me njëri-tjetrin, ka qëndrueshmëri, atje “ka solidaritet, takohesh dhe buzëqesh”, tregon ai. Por ka edhe dhunë, trafikim, vrasje. Si rasti i vëllait të tij të madh, trupi i djegur i të cilit u gjet brenda një makine pak pas krijimit të shoqatës. “Sot gjërat nuk kanë ndryshuar: gjithnjë e më shumë vdekje, gjithnjë e më shumë dhunë, gjithnjë e më shumë barbari”, vazhdon Amine, “por lufta jonë për një jetë dinjitoze sapo ka filluar”. Gjithnjë e më shumë barbarizëm, thotë Amine, dhe statistikat franceze e konfirmojnë këtë. Në tetë muajt e parë të vitit 2023, vetëm pesë tregues nga 13 janë në rënie. Në rritje, ndër të tjera: vjedhjet, vjedhjet e makinave, vandalizmi, sulmet dhe mbi të gjitha vrasjet, me një +8 për qindësh, që shton rritjen tashmë mbresëlënëse të vitit të kaluar. Në vitin 2022 kishte 948 viktima dhe që në 2020 ishin 879, në rritje, me 12 vrasje për milion banorë, krahasuar me 4.9 në Itali (që francezë t e quajnë ende “Le pays de la mafia”).

Të dhënat mbi dhunën e perceptuar nga shoqëria peshojnë gjithashtu: 10 për qind e francezëve thonë se ndihen të pasigurt në lagjen ose fshatin e tyre. Një e dhënë që rritet në 26 për qind në periferitë urbane, ku prania e policisë është më e rrallë. Fondacioni Jean Jaurès, në raportin e tij Fractures Sociales, vëren se 87 për qind e francezëve e perceptojnë dhunën në rritje. Është shqetësimi i katërt kryesor (pas fuqisë blerëse, mjedisit dhe statusit social), në të njëjtin nivel me emigracionin. Nga ana tjetër, perceptimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis dhunës dhe emigracionit është gjithnjë e më i përhapur. Një ndjesi e konfirmuar pjesërisht nga ministri i Brendshëm Gérald Darmanin, i cili saktësoi në Parlament se në vitin 2022, ishin kryer nga të huaj, të cilët përfaqësojnë vetëm 8 për qind të popullsisë franceze: 41 për qind e totalit të vjedhjeve, 35 për qind e vjedhjeve të dhunshme pa përdorimin e armëve, 17 për qind e sulmeve dhe po aq për vrasje. Sipas Alain Bauer, kriminologu më i njohur francez, ky disproporcion është më shumë për shkak të moshës së re, sesa faktit të të qenit

emigrant. Djem të rinj, që kanë një tendencë më të madhe ndaj dhunës. Por thjesht kini parasysh se në vitin 2022 janë kryer afërsisht 125 mijë gjymtime gjenitale femrash, një krim, për të kuptuar se matrica etnike dhe sociale nuk mund të mos peshojë. Didier Leschi, i cili ka drejtuar OFFI, zyrën franceze të imigracionit dhe integritit, që nga viti 2015, konfirmon për Panorama se “80 për qind e kërkesave për azil në Francë vijnë nga meshkujt”. Mes të cilëve ndonjëherë nuk ka dëshirë për t’u integruar. Një pakicë që “prirët të rritet me rritjen e flukseve”. Një nga faktorët e mungesës së integritit është feja: “Në mungesë të ideologjive të tjera të disponueshme, të rinjtë, mbi të gjitha, janë tërhequr nga islamizmi radikal”, shpjegon më tej Leschi. Problemi përqësohet nga kontaktet më të lehta me vendin e originës sesa në të kaluarën: rrjetet satelitore dhe televizorët kontribuojnë për të mbajtur një mjedis kulturor ndonjëherë edhe armiqësor ndaj shoqërisë pritëse. / Me shkurtime nga Panorama Italia – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova barazon me Bullgarinë në 'Zahir Pajaziti'

Prishtinë, 17 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës U21 ka barazuar me Bullgarinë, në stadiumin "Zahir Pajaziti", me rezultat 2-2, në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2025. "Dardanët" të udhëhequr nga Afrim Tovërlani

pësuan gol qysh në fillim, kur në minutën e 8-të realizoi Martin Sorakov. Pas rezultatit 0-1, Kosova iu vërsul Bullgarisë, derisa në minutën e 34-t shënoi golin e barazimit përmes Ardit Tahirit, i cili ndryshoi shifrat për 1-1. Minutat në vazhdim

kaluan me dëshirën e Dardanëve për dominim, por një lëshim në mbrojtje në minutën e fundit të kohës së rregullt bëri që Bullgaria të përfitojë dhe të kalojë sërish në epërsi me golin e Martin Petkov. Pjesën e dytë "Dardanët" e

nisën mbarë dhe pas disa aksioneve të njëpasnjëshme arritën që në minutën 59-të të barazojnë shifrat. Autor i golit sërish ishte Ardit Tahiri. Lojë dinamike dhe me raste në të dyja anët u zhvillua edhe në pjesën e mbetur të takimit por



rezultati mbeti i pandryshuar (2-2).

Shqipëria e mrekullueshme, siguron kualifikimin në Kampionatin Evropian

Populli shqiptar është në festë, pasi kombëtarja e tyre ka siguruar kualifikimin në finalen e Kampionatit Evropian, i cili mbahet në verën e ardhshme në Gjermani. Barazimi 1-1 ndaj Moldavisë të premtën në mbrëmje ka qenë i mjaftueshëm për kuqezinjtë që të sigurojnë suksesin e dytë historik duke u kualifikuar në një kompeticion të madh

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll ka bërë mrekullinë duke e siguruar kualifikimin në Kampionatin Evropian "Euro 2024", për herë të dytë në histori të saj. Kuqezinjtë një sukses të tillë e kishin arritur edhe në vitin 2016. "Meritë e djemve dhe të gjithë njerëzve që na kanë mbështetur, është nder të jem trajneri i kombëtares së Shqipërisë dhe të ndjej pasionin e njerëzve. Gjithçka është shumë e bukur. Nuk është vetëm Sylvinho, është Zabaleta, Doriva, Bulku i

gjithë stafi. Më shumë se taktika është pasioni dhe dashuria për futbollin, ka pasion në punën tonë. Rezultati nuk vjen shpejt, ne kemi bërë një punë të mirë dhe kemi marrë rezultat, është një kombinim i mirë. Moldavia po luante për gjithçka, nuk kishin çfarë të humbnin. Luanin me topa të gjatë dhe ishte e vështirë, ata nuk kanë humbur në shtëpi. Kanë humbur vetëm një ndeshje në kualifikuese, kundër nesh në Shqipëri. Kombëtarja është e hapur për lojtarë të rinj, kemi një skuadër të konsoliduar, por kjo është puna e një kombëtareje, jemi gati të presim lojtarë që janë



në formë", ka thënë Sylvinho, trajneri i Shqipërisë. Deri të ky sukses i jashtëzakonshëm, Shqipëria erdhi pas barazimit ndaj Moldavisë me rezultat 1-1. Në minutën e 25-të, Taulant Seferi në tentim për të dribluar në zonën e rreptësisë pengohet dhe gjyqtari kryesor akordon penallti,

të cilën në gol e konvertoi Sokol Cikalleshi. Pjesa e parë përfundoi me rezultat 0-1. Pjesa e dytë ishte ashtu siç pritej, me Moldavinë e cila tentoi disa herë të gjente golin e barazimit, duke i vendosur kuqezinjtë shpesh në vështirësi. Shqipëria pati edhe një rast të mirë shënimi, por goditjen e

Seferit e ndalen portieri moldav dhe shtylla. Moldavia arriti të barazon rezultat në minutën e 87-të, autor i golit ishte Vladislav Baboglos. Ky barazim i dërgon kuqezinjtë në Gjermani, në "EURO 2024", për herë të dytë në histori në këtë kompeticion. Shqipëria ka bërë një rrugëtim perfekt në këto kualifikuese, duke u pozicionuar tashmë aktualisht në vendin e parë me 14 pikë. Pas suksesit të ekipit kuqez, UEFA do të shpërblejë FSHF-në. Suksesi është 9.25 milionë euro, shifër kjo që do jetë e njëjtë për 24 ekipet pjesëmarrëse në këtë event. UEFA akordon edhe bonese prej 1.5 milionë euro për çdo fitore dhe 750 mijë euro për çdo barazim në fazën finale. Nëse tanët kalojnë grupin e fazës finale, një bonus shtesë prej 2 milionë eurosh do kalonte në arkat e FSHF-së. Veç saj, bonus prej 5 milionë eurosh do kishte edhe për secilin ekip që mbërrin në fazën gjysmëfinale.

Kosova shpreson në fitore ndaj Zvicrës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e motivuar pas fitores ndaj Izraelit sonte (e shtunë) do të kërkojë edhe një tjetër rezultat pozitiv ndaj Zvicrës në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2024". "Dardanët" shpresojnë në fitore në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "St Jakob-Park", pasi me tri pikë i ruajnë shanset për kualifikim në "Euro 2024". Lidhur me këtë ndeshje ka folur përzgjedhësi

Primozh Gliha, i cili ka deklaruar se nëse Kosova dëshiron një rezultat pozitiv, atëherë futbollistët duhet të jenë shumë inteligjentë për faktin se përballë e kanë një kundërshtar të fortë. "Do të jetë një ndeshje e vështirë. Edhe pse në Prishtinë luajmë bars, ishte një ndeshje shumë e fortë. Ne e mposhtëm Izraelin, por izraelitët treguan se janë të fortë pasi barazuan me Zvicrën. Presioni do të jetë shumë i madh pasi do të kemi përkrahje të madhe të publikut. Nëse duam të arrijmë rezultat pozitiv, duhet të jemi shumë inteligjentë dhe të



dimë si të luajmë, sepse kemi të bëjmë me një kundërshtar shumë të fortë. Tani jemi në një situatë ku kemi pak gjasa. Por, kjo nuk ndryshon asgjë pasi jam shumë i fokusuar te ndeshja me Zvicrën sikurse ndaj çdo kundërshtari tjetër", ka thënë Gliha. Krahas përzgjedhësit në konferencë për medie ishte edhe mbrojtësi Florent Hadërgjonaj. Ky i fundit ka deklaruar se presion paraqitje të mirë dhe shpresojnë në fitore për të gëzuar popullin e Kosovës. "Për mua është ndeshje speciale, pasi kam lindur dhe jam rritur këtu.

Nuk do ta harroj gjatë tërë jetës sime pasi do të kem shumë familjarë në tribuna. Nuk do të jetë një situatë e tillë vetëm për mua, por edhe për shumë bashkëlojtarë. Me padurim presim ndeshjen, pasi në stadium do të kemi përkrahje të madhe dhe shpresoj që me një paraqitje të mirë do ta gëzojmë popullin kosovar dhe të gjithë ata në stadium me një fitore", ka thënë Hadërgjonaj. Ndeshja mes Zvicrës dhe Kosovës do të zhvillohet nga ora 20:45. Zvicra është e para më 16 pikë, kurse Kosova e katërta më 10 pikë.

MKRS-ja mbështetë financiarisht Komitetin Paralimpik të Kosovës

Prishtinë, 17 nëntor - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetë financiarisht pjesëmarrjen e parë të paraatletëve të Kosovës në Lojërat Paralimpike "Paris 2024". Komiteti Paralimpik i Kosovës së fundi është anëtarësuar në Komitetin

Paralimpik Evropian dhe Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar, duke i mundësuar kështu paraatletëve kosovarë që në vitin e ardhshëm të garojnë për herë të parë në Lojërat Paralimpike që do të mbahen në Paris, duke gëzuar të drejta

të plota. Përmes memorandumit të nënshkruar të premtën ndërmjet ministrit Hajrulla Çeku dhe presidentes së KPK-së, Njomza Emini, MKRS-ja mbështetë financiarisht Komitetin Paralimpik të Kosovës me qëllim të përgatitjes së ekipit

paralimpik të Kosovës për pjesëmarrjen në Paris. Në Lojërat Verore Paralimpike 2024 pritet që të marrin pjesë mbi 160 shtete me më shumë se 4000 parasportistë, të cilët do të garojnë në 22 sporte të ndryshme. Kosovën në këtë ngjarje pritet ta përfaqësojnë dy



parasportistët, Grevist Bytyqi dhe Vjollca Hoxha.

Nadali: Nuk e kam ndërmend të pensionohem nga tenisi

MAJORKA, 17 NËNTOR - Rafael Nadal nuk është ende gati për t'i thënë "lamtumirë" sportit. Tenisti nga Majorka, që këtë vit nuk luan që prej janarit për shkak të lëndimit, ka folur nga Barcelona për të ardhmen. "Nëse doni të dini diçka të re për mua, ju them se do të vazhdoj të luaj tenis", ka thënë

Nadal. "Nuk e di ende se ku dhe kur do të rikthehem, pasi nuk jam ende i qartë për këtë gjë. Por jam i lumtur për mënyrën se si po shkojnë gjërat", u shpreh tenisti spanjoll, për të cilin u përfol se do të rikthehet në janar 2024 në grand slam-in e "Australian Open". "E kuptoj

rëndësinë e atij lajmi, por kur ta kuptoj se kur dhe ku do të kthehem do t'ju njoftoj. Do të jem unë i pari që do t'jua zbuloj të ardhmen. Jam i vetëdijshëm se do të jetë shumë e vështirë të rikthehem lojtari i dikurshëm, por nëse nuk do të kisha iluzione do të isha larguar prej kohësh. Kam

muaj që luftoj për këtë rikthim pasi besoj te vetja pavarësisht prej moshës. Karriera ime ka qenë shumë e gjatë dhe nuk e mohoj që vitet kalojnë. Djokoviçi ka fituar 24 grand slame dhe nuk besoj se do ta arrij. Është një objektivi që nuk e arrij dot. Jetoj në një realitet ndryshe nga e kaluara, pasi



nuk luaj që një vit", ka deklaruar Nadal.

Evertoni shkeli rregullat e Premierë Ligës, i hiqen 10 pikë nga renditja

LIVERPOOL, 17 NËNTOR - Shkelja e rregullave financiare në futboll, pavarësisht se nuk trajtohet shumë, është një nga problematikat më të mëdha në botën e këtij sporti, ku klube të ndryshme, si ato të miliardave, por edhe ato të "qindarkave", herë pas here nuk shpëtojnë pa u ndëshkuar nga bordi drejtues i kampionateve vendase e i tillë është edhe rasti i "gjigantëve" anglezë të Evertonit. Këta të fundit kanë marrë këtë të premte një ndëshkim nga bordi i Premierë Ligës, me ulje prej 10 pikësh, pas shkeljes së këtyre rregullave. Gjithçka është mësuar nga një deklaratë për mediet, nga vetë Premierë Ligë, në të cilën thuhet se pas një anekse kundër klubit, komisioni i pavarur që hetoi çështjen vendosi t'u japë "bluve" të Liverpoolit dënimin drastik. "Një panel i pavarur ka vendosur një zbritje prej 10 pikësh për Evertonin për shkeljen e rregullorevë të përfitimit dhe qëndrueshmërisë (PSR). Ai hyn në fuqi menjëherë. Premierë Liga paraqiti një anekse kundër klubit dhe ia referoi



çështjen një komisioni të pavarur në fillim të këtij viti. Gjatë procedurave klubi pranoi se kishte shkelur PSR-të për periudhën që përfundon me sezonin 2021/22, por shtrirja e shkeljes mbeti e diskutueshme. Pas një seance dëgjimore pesëditore muajin e kaluar, komisioni zbuloi se llogaritja e PSR-ve nga Evertoni për periudhën përkatëse rezultoi në një humbje prej 124.5 milionë £, siç pretendohet nga Premierë Liga. Kjo e tejkaloi pragun prej 105

milionë £ të lejuar sipas PSR-ve. Komisioni konkludoi se duhet të zbatohet një sanksion sportiv prej 10 pikësh. Ky sanksion hyn në fuqi menjëherë", thuhet në deklaratë. Pas heqjes së këtyre pikëve, tashmë Evertoni rrezikon jo pak mbijetesën në elitën e futbollit anglez, teksa nga vendi i 14 në tabelë që ndodhej, me 14 pikë, shkon në vendin e parafundit të renditjes, me vetëm 4 pikë, po aq sa Burnley, por me një golavarazh më të mirë.

Sot dy ndeshje në Superligë

Prishtinë, 17 nëntor - Të shtunën do të zhvillohen dy ndeshjet e xhiros së nëntë të Prince Caffë Superligës. Vëllaznimi do ta kërkojë fitoren e pestë radhazi. Kuqezinjtë janë motivuar sidomos pas fitoreve ndaj Sigal Prishtinës dhe Pejës, ndërsa do të ballafaqohen me Bashkimin, që pas një starti shumë të mirë, ka pasur rënie të formës. Vëllaznimi ka katër fitore e katër humbje, ndërsa Bashkimi tri fitore e pesë humbje. Takimi tjetër i së shtunës është ndërmjet Istogut dhe Golden



Eagle Yllit, sfidë që zhvillohet në Therandë. Istogasi janë në vendin e fundit me një fitore e shtatë humbje, kurse therandasit kanë katër fitore e katër humbje. Për

shkak të garave ndërkombëtare të skuadrave të Kosovës, ndeshjet Peja - Proton Cable Prizreni dhe Prishtina - Trepça zhvillohen më 29 nëntor.

SUPERLIGA - Java 9

Të shtunën takohen:
17:00 Vëllaznimi-Bashkimi
19:00 Istogu-Golden Eagle Ylli

Më 29 nëntor takohen:
Peja-Proton Cable Prizreni
Sigal Prishtina-Trepça

SHKURT

Ekipi i Kosovës në xhudo po stërvitet në Japoni

Prej disa ditësh ekipi i Kosovës në xhudo është në Yamanashi, në afërsi të Tokios. Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Laura Fazliu, Lorian Kuka, Akil Gjakova, Shpati Zekaj dhe Blini Kukaj, bashkë me trajnerët Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi, po mbajnë përgatitjet tashmë për herë të dytë në shkollën e xhudos në Japoni. Këto përgatitje po bëhen për garat e radhës dhe Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Kjo nuk është hera e parë që Kosova po stërvitet në Japoni, pasi ishte pjesë e këtij kampi në vitin 2015. Kujtojmë që pikërisht në Japoni në vitin 2021, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi fituan medalje të arta olimpikë.

U hodh shorti për rrethin e parë të Kupës së Kosovës

Në lokalet e Federatës së Futbollit të Kosovës të premtën, në prani të përfaqësuesve të klubeve, është bërë tërheqja e shortit për rrethin e parë të Kupës së Kosovës në futboll. Ndeshjet e këtij rrethit zhvillohen të mërkurën më 22 nëntor me fillim nga ora 13:00, ndërkohë që sipas shortit takohen: Istogu 03 - Behar dhe KEK-u - Dardania. Dy skuadrat fituese kalojnë në rrethin e dytë, ku i presin skuadrat e Superligës dhe Ligës së Parë.

Golden State pëson humbjen e gjashtë radhazi, triumfon Miami

Vetëm dy ndeshje janë luajtur në NBA e surprizat nuk kanë munguar. Miami mposhti me rezultat 122-115 Brooklynin, në një ndeshje të fortë deri në fund. Bridges e Walkeri realizuan nga 23 pikë për Netsin, por që s'mjaftuan për të fituar. Për Miamin, Butleri realizoi 36 pikë e Robinsoni 26, duke bërë dallimin në fushë. Vijon kriza e ekipit të Golden States, që pa disa nga yjet në fushë, u mund me rezultat 128-109 nga Oklahoma. Për Warriorsin kjo është humbja e gjashtë radhazi, duke dalë nga zona "play-off". Për Oklahoman u dalluan Shai me 24 pikë e Joe me 23 pikë.

City synon rikthimin e Sanes

Ylli i Bayern Munchenit, Leroy Sane, është lidhur me një rikthim të bujshëm në Manchester City. "Bild" raporton se kampionët në fuqi të Evropës do ta rivalizojnë interesimin e Liverpoolit për ta rrëmbyer ish-anësozin e tyre. 27-vjeçari ka qenë në formë të shkëlqyer për Bayernin këtë sezon dhe ka përfutuar veçanërisht nga ardhja e Harry Kanes. Anësozi ka shënuar tetë gola dhe ka dhuruar gjashtë asistime në 11 ndeshje të Bundesligës këtë sezon. Sane ka kontratë me klubin gjerman deri në vitin 2025, kurse transferimi i tij i kishte kushtuar Bayernit 54.1 milionë funte në vitin 2020.

Messi, futbollistëve të rinj të Uruguait: Mësoni nga veteranët, kini respekt

Argjentina pësoi humbje nga Uruguai me rezultat 0-2. Në këtë ndeshje nuk munguan edhe përplasjet e forta në fushë, ku protagonist ishte Leo Messi. Kapiteni i

Argjentinës nuk i kurseu shigjetimet për futbollistët kundërshtarë në lidhje me këtë ngjarje. "Më mirë nuk po e them atë që mendoj, po lojtarët e rinj duhet të

mësojnë dhe të rriten. Uruguai ka një grup të mirë lojtarësh, por ata duhet të mësojnë nga 'veteranët' se çfarë është respekti. Këto lloj ndeshjesh janë gjithmonë

intensive, por respekti mes palëve nuk mungon asnjëherë. Kështu që tek Uruguai duhet ta mësojnë një gjë të tillë", ka thënë tetë herë fituesi i "Topit të Artë".

Në një moment përplasjeje mes futbollistëve, Messi u shfaq tepër agresiv duke kapur për fyti Mathias Oliveran, mbrojtësin e Napolit në Serinë A.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Selmani Consulting” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Albulena Selmani, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811998494 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Selmani Consulting” D.O.O. Gnjilane, sa vllasnikom Albulena Selmani, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811998494 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Selmani Consulting” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Albulena Selmani, has come to the decision to quit its business: 811998494 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

Emri i biznesit B5 Inframain SH.P.K. si dhe me emër tregtar B5 Infrastructur&Maintance me Numër Unik Identifikues: 811574583, ka marr vendim për zvogëlim të kapitalit nga 2000.000 në 20.000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- S&A&A Group SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me Numër Unik Identifikues: 810178196.
- Habib Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu "Lidhja e Prizrenit " Prizren.
- Arsen Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Abdyl Frashri " Prizren.
- Gjezair Ademaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VII shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.
- Ragip Reshani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VI shfmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishe.
- Miradije Vokshi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.
- Blerim Polloshka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

